



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveri-Vlada-Government

RREGULLORE (QRK) Nr. 25/2020 PËR METODOLOGJINË E HARTIMIT TË VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË¹

REGULATION (GRK) No.25/2020 ON THE METHODOLOGY FOR RISK ASSESSMENT DEVELOPMENT²

UREDBA (VRK) Br. 25/2020 O METODOLOGIJI IZRADE PROCENE OPASNOSTI³

¹ Rregullorja (QRK) – Nr.25/2020 për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë, është miratuar në mbledhjen e 43 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.06/43, datë 13.11.2020.

² Regulation (GRK) – Nr.25/2020 on the methodology for risk assessment development, was approved on the 43 meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No. 06/43, dated 13.11.2020.

³ Uredbe (VRK) – Br.25/2020 o metodologiji izrade procene opasnosti, usvojen je na 43 sednicu Vlade Kosova sa Odlukom Br.06/43, datum 13.11.2020.

<p>Qeveria e Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 44 të Ligjit nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera (GZ nr.22/ 19.10.2011), në pajtim me nenin 4 të Rregullores nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (GZ nr.01/03 06.06.2020), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.07/2020, si dhe në nenin 19 (6.2) të Rregullores nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë, (GZ nr. 15 / 12.09.2011).</p> <p>Miraton:</p> <p>RREGULLORE (QRK) Nr.25/2020 PËR METODOLOGJINË E HARTIMIT TË VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË</p> <p>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>1. Me këtë Rregullore përcaktohet metodologjia për hartimin e vlerësimit të rrezikshmërisë (në tekstin e mëtejshëm vlerësimi) së popullatës, të mirave</p>	<p>Government of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, Article 44 of the Law 04/L-027 for Protection against Natural and other Disaster (OG no. 22/ 19.10.2011) pursuant to Article 4 of Regulation No. 06/2020 on Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries (OG, No.01/03 06.06.2020), amended and supplemented by regulation (QRK) N0.07/2020 and based on the Article 19 (6.2) of the Regulation No. 09/2011 on Rules of Procedure of the Government, (OG no. 15 /12.09.2011).</p> <p>Adopts:</p> <p>REGULATION (GRK) No. 25/2020 ON THE METHODOLOGY FOR RISK ASSESSMENT DEVELOPMENT</p> <p>GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>1. By means of this Regulation shall be defined the methodology on developing the risk assessment (hereinafter: assessment) of the population, material and cultural goods</p>	<p>Vlada Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosovo, i člana 44 Zakona 04/-027 o zaštiti od prirodnih i drugih katastrofa (SL br. 22 / 19.10.2011) u skladu sa članom 4 Uredbe Br .06/2020o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava (SL br. 01/03, od 06.06.2020), Izmenjena i Dopunjena Uredbom (NRC) Br.07/2020 i na osnovu člana 19 (6.2) Pravilnika o radu Vlade br. 09/2011, (SL br. 15 / 12.09.2011).</p> <p>Usvaja:</p> <p>UREDBA (VRK) BR. 25/2020 O METODOLOGIJI IZRADE PROCENE OPASNOSTI</p> <p>OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 1 Cilj</p> <p>1. Ovom Uredbom se određuje metodologija za izradu procene opasnosti (u daljem tekstu:procena) stanovništva, materijalnih i kulturnih dobara od prirodnih i</p>
--	---	---

<p>materiale dhe kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, bartësit dhe pjesëmarrësit në hartimin e vlerësimit, procedurat për hartimin dhe miratimin e saj.</p> <p>2. Kjo Rregullore transponon pjesërisht Direktivën 2012/18 EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës: 04. 07.2012 për Kontrollin e Rreziqeve të Aksidenteve të Mëdha që Përfshijnë Materie të Rrezikshme SEVESO III) dhe Direktivën 2007/2/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës:14.03.2007 për Themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinor në Komunitetin Evropian (INSPIRE), si dhe në harmoni me Udhëzuesin Teknik nga Programi i BE-së/IPA DRAM.</p>	<p>from the natural and other disasters, stakeholders and participants in drafting the assessment, as well as procedures for its drafting and approval.</p> <p>2. This Regulation partially transposes Directive 2012/18 EU of the European Parliament and of the Council dated 04.07.2012 on the control of major-accident hazards involving dangerous substances SEVESO III) and Directive 2007/2/EC of the European Parliament and of the Council dated 14.03.2007 establishing an Infrastructure for Spatial Information in the European Community (INSPIRE) and in compliance with the Technical Guidance of EU-IPA DRAM Programme.</p>	<p>drugih nepogoda, nosioci i učesnici u izradi procene, procedure za njenu izradu i njeno usvajanje.</p> <p>2. Ovom se Uredbom delimično prenosi Direktiva 2012/18 EU Evropskog parlamenta i Saveta od 04. 07. 2012. o kontroli opasnosti od većih nepogoda koje uključuju opasne tvari SEVESO (III) i Direktiva 2007/2/EC Evropskog parlamenta i Saveta od: 14. 03. 2007. godine o osnivanju infrastrukture za prostorne informacije u Evropskoj zajednici (INSPIRE) i u skladu sa Tehničkim uputstvom EU / IPA DRAM programa.</p>
<p>Neni 2 Përkufizimet</p>	<p>Article 2 Definitions</p>	<p>Član 2 Definicije</p>
<p>1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin si në vijim:</p> <p>1.1. Vlerësimi i rrezikut - analizat cilësore dhe sasore të rrethanave natyrore dhe të tjera të lidhura me ndodhitë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, përfshirë vlerësimin e drejtimin të mundshëm të zhvillimit dhe pasojave të</p>	<p>1. Terms used in this Regulation shall have the following meaning:</p> <p>1.1. Risk Assessment – quality and quantity analyses of natural and other related circumstances of natural and other disasters, including therein the possible direction of development and possible consequences from disasters, level of proposed protection against</p>	<p>1. Izrazi korišćeni u ovoj uredbi imaju sledeći značaj:</p> <p>1.1. Procena opasnosti-kvantitativne i kvalitativne analize prirodnih i drugih okolnosti vezanih sa dešavanjem prirodnih i drugih nepogoda, uključujući procenu mogućeg smera razvoja i mogućih posledica nepogoda, kao i predloženi nivo zaštite od dotičnih</p>

<p>mundshme nga fatkeqësia, nivelin e propozuar të mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe propozimin për masat parandaluese dhe të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;</p> <p>1.2. Fatkeqësi natyrore - janë: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortek, erë e fuqishme, breshër, borë me shi, acar, thatësi, zjarr fushor, shpërthim i sëmundjeve infektive që ndikojnë në njerëz, kafshë ose bimë dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore;</p> <p>1.3. Fatkeqësi tjera - janë: aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, fatkeqësitë në miniera, shkatërrimet e pendave, aksidentet nukleare dhe aksidentet tjera ekologjike dhe industriale të shkaktuara nga aktivitetet dhe veprimet e njeriut, lufta dhe gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste me mjete klasike dhe forma tjera të dhunës në masë;</p> <p>1.4. Infrastruktura Kritike Kombëtare - një aset, sistem apo pjesë të saj të domosdoshme për</p>	<p>relevant risks and proposal for preventive and other measures for protection, rescue and aid;</p> <p>1.2. Natural disasters – earthquakes, landslides, floods, avalanches, heavy snow, strong wind, hail, ice, drought, massive appearance of contagious diseases on people, animals and plants as well as other disasters, which are caused by the nature forces;</p> <p>1.3. Other disasters – heavy traffic accidents, air and railway traffic, fire, mine accidents, damage of dams and other ecological and industrial disasters, which are caused by human beings, due to their work and behavior, extraordinary emergent situations high temperature, technical collapse of the energy system with power supply, telecommunication and informative technology, terrorist acts and other types of massive violence;</p> <p>1.4. National Critical Infrastructure – an asset, system or part thereof, necessary for maintaining vital and</p>	<p>opasnosti i predlog za mere sprečavanja i druge mere za zaštitu, spašavanje i pomoć;</p> <p>1.2. Prirodne nepogode - zemljotresi, poplave, odron zemlje, smetovi, jak vetar, grad, sneg i kiša, mraz, suša, vatra na otvorenom prostoru, izbijanje infektivnih bolesti koje utiču na ljude, stoku i bilje i druge nepogode nastalih od prirodnih sila;</p> <p>1.3. Druge nepogode - nesreće koje obuhvataju putni, železnički i vazdušni saobraćaj, požari, nesreće u rudnicima, rušenje brana, nuklearne nesreće i ekološke i industrijske nesreće prouzrokovane od strane ljudskih aktivnosti i delovanja, zatim od rata i emergentih situacija, upotrebe oružja i sredstva za uništenje u masi, od strane terorista sa klasičnim sredstvima i u drugim formama uništenja u masia;</p> <p>1.4. Nacionalna kritična infrastruktura- je imovina, sistem ili njeni neophodni delovi za održavanje</p>
--	--	--

<p>mirëmbajtjen e funksioneve jetike dhe sociale, shëndetit, sigurisë, mirëqenies ekonomike ose sociale të njerëzve dhe çrregullimi ose shkatërrimi i së cilës do të kishte një ndikim të konsiderueshëm në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. Skenari- është përshkrim i ngjarjeve të dëmshme të ndërlydhura për secilin rrezik, që shkakton pasoja në jetën dhe shëndetin e njerëzve, në ekonomi, stabilitet shoqëror dhe mjedis.</p> <p>2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin ashtu siç përcaktohet në Ligjin nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Vlerësimi i rrezikshmërisë</p> <p>1. Vlerësimi është dokument bazë për hartimin e planeve të reagimit emergjent, planeve operative dhe planeve tjera sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>2. Vlerësimi duhet të hartohet në nivel qendror, lokal, për kryeqytetin e Kosovës dhe personat juridik.</p>	<p>social functions, healthcare, security, economic or social welfare of people, whose disturbance or destruction would have a significant impact on the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. Scenario – a description of harmful occurrences related to any of the risks, which causes consequences to the life and health of people, economy, social stability and environment.</p> <p>2. Expressions used in this Regulation shall have the same meaning as determined under the Law No. 04/L-207 for Protection against Natural and Other Disasters.</p> <p style="text-align: center;">Article 3 Risk Assessment</p> <p>1. Assessment shall be the base document for drafting emergency response plans, operative plans and other plans under the applicable legislation.</p> <p>2. Assessment shall be developed for the central and local level and for the Capital of Kosovo and legal persons.</p>	<p>vitalnih i socijalnih funkcija, zdravlja, bezbednosti, socijalnog ili ekonomskog blagostanja ljudi ili poremećaj ili uništenje bilo koje od njih imalo bi značajan uticaj u Republici Kosovo;</p> <p>1.5. Scenarij - je opis štetnih događaja povezanih sa svakom opasnošću, koji prouzrokuju posledice po život i zdravlje ljudi, ekonomiju, socijalnu stabilnost i životnu sredinu;</p> <p>2. Ostali izrazi koji se koriste u ovoj uredbi imaju značenje koje je utvrđeno u Zakonu br. 04/L-027 o zaštiti od prirodnih i drugih nepogoda, kao i relevantnim važećim zakonodavstvom.</p> <p style="text-align: center;">Član 3 Procena opasnosti</p> <p>1. Procena je osnovni dokument za izradu planova za reagovanje u vanrednim situacijama, operativnih i drugih planova prema relevantnom važećem zakonodavstvu.</p> <p>2. Procena treba da se izradi na centralnom, lokalnom nivou, za glavni grad Kosova i za pravna lica;</p>
--	---	--

<p>3. Vlerësimin e kanë të obliguar ta hartojnë:</p> <p>3.1. Personat juridik – operatorët të cilët posedojnë apo menaxhojnë me objekte apo reparte në të cilat janë të pranishme materiet e rrezikshme sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>3.2. Personat juridik, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me objektet e infrastrukturës kritike, përkatësisht objekteve të rëndësisë së veçantë për funksionimin e shoqërisë dhe ekonomisë në zonat të cilat paraqesin prioritet të veçantë në planifikimin e mbrojtjes dhe shpëtimit, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së funksioneve të tyre apo rimëkëmbjes sa më të shpejtë dhe rivendosjes së funksioneve në kapacitetin e plotë dhe në afat sa më të shkurtër pas fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.</p> <p>4. Vlerësimet e personave juridik, nga paragrafi 3 i këtij neni, përfshijnë objektet dhe hapësirat në pronësi apo shfrytëzim të tyre, si dhe hapësirat përreth këtyre objekteve të cilat mund të rrezikohen nga efektet e fatkeqësive, përkatësisht pasojave në komunitetin e gjerë, në rastet e</p>	<p>3. The following shall be obliged to develop the assessment:</p> <p>3.1. Legal persons – operators who possess or manage facilities or departments in which hazardous materials as per applicable legislation, are present;</p> <p>3.2. Legal persons, whose activities are related to critical infrastructure facilities, respectively facilities of particular importance for the functioning of society and economy in the areas that pose special priority in planning the protection and rescue, with the view to protect and preserve their functions or faster recovery and restoration of functions in full capacity and in the shortest deadline following natural and other disasters.</p> <p>4. Assessments of legal persons referred to in paragraph 3 of this Article shall include facilities and spaces under ownership or use, as well as spaces surrounding these facilities which may be threatened by the hazardous effects of disasters, i.e. the wider community, in cases of termination or</p>	<p>3. Procenu su dužni da izrade:</p> <p>3.1. Pravna lica- operateri koji poseduju ili upravljaju objektima ili pogonima u kojima su prisutne opasne materija na osnovu važećeg zakonodavstva;</p> <p>3.2. Pravna lica čija je delatnost povezana sa objektima kritične infrastrukturne, odnosno objektima od posebnog značaja za funkcionisanje društva i ekonomije u oblastima koje predstavljaju posebne prioritete u planiranju zaštite i spašavanja, u cilju zaštite i očuvanja njihove funkcije ili oporavka u najkraćem mogućem roku i uspostavljanje funkcija u punom kapacitetu i u najkraćem mogućem roku nakon prirodnih i drugih katastrofa.</p> <p>4. Procene pravnih lica iz stava 3.. ovog člana uključuju objekte i prostorije koje su u njihovom vlasništvu ili korišćenju, kao i prostore oko ovih objekata koji mogu biti ugroženi od uticaja katastrofa, odnosno posledica u široj zajednici u slučajevima prekida rada ili značajnih poremećaja.</p>
---	--	---

<p>ndërprerjes së punës apo çrregullimeve të konsiderueshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Përmbajtja e fushës së vlerësimit të rrezikshmërisë</p> <p>1. Me anë të vlerësimit analizohen kërcënimet e mundshme të popullatës, të mirave materiale, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, shkatërrimet luftarake dhe terrorizmi.</p> <p>2. Hapat e procesit të analizimit të rrezikut:</p> <ul style="list-style-type: none"> 2.1. Identifikon rrezikun; 2.2. Profilizon secilin rrezik; 2.3. Ndërton profilin e komunitetit; 2.4. Përcakton cenueshmërinë; 2.5. Krijon dhe aplikon skenarët. 	<p>significant disorders of work.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Content of the risk assessment scope</p> <p>1. This assessment shall analyse possible threats against the population, material goods, cultural heritage and the environment from natural and other disasters, as well as military destruction and terrorism.</p> <p>2. The steps of risk analysing process shall include:</p> <ul style="list-style-type: none"> 2.1. Identify risk; 2.2. Profile each risk; 2.3. Build the community profile; 2.4. Determine vulnerability; 2.5. Establish and apply scenarios. 	<p style="text-align: center;">Član 4 Sadržaj oblasti procene opasnosti</p> <p>1. Procenom se analiziraju potencijalne prijetnje stanovništvu, materijalnim dobrima, kulturnom nasleđu i životnoj sredini od prirodnih i drugih katastrofa, ratnih razaranja i terorizma.</p> <p>2. Koraci procesa analiziranja opasnosti:</p> <ul style="list-style-type: none"> 2.1. Identifikuje opasnosti; 2.2. Vršiti profilizaciju svake opasnosti; 2.3. Izgrađuje profil zajednice; 2.4. Određuje ugroženost; 2.5. Izrađuje i sprovodi scenarij.
<p style="text-align: center;">Neni 5 Pjesët e vlerësimit</p> <p>1. Pjesë integrale të vlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1.1. Llojet, intensiteti, efektet dhe 	<p style="text-align: center;">Article 5 Assessment parts</p> <p>1. Integral parts of assessment shall be:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1.1. Types, intensity, effects and 	<p style="text-align: center;">Član 5 Delovi procene</p> <p>1. Sastavni deo procene su:</p>

<p>pasojat e mundshme të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, në popullatë, të mira materiale, kulturore dhe mjedis;</p> <p>1.2. Vlerësimi dhe pasojat e infrastrukturës kritike;</p> <p>1.3. Vlerësimet përfundimtare-specifike;</p> <p>1.4. Matrica e rreziqeve;</p> <p>1.5. Skenarët;</p> <p>1.6. Hartat.</p> <p>2. Të dhënat për pozitën dhe karakteristikat e territorit për të cilën hartohet dokumenti i vlerësimit janë bazë për analizimin e pjesëve sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe pjesë e shtojcave të vlerësimit.</p> <p>3. Autoritetet e nivelit lokal, në planet e tyre zhvillimore duhet të përfshijnë vlerësimin e rreziqeve dhe masat parandaluese, me zbatimin e të cilave do të zvogëlohen pasojat dhe efektet e fatkeqësive me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë së popullatës, të mirave materiale, infrastrukturës kritike, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit.</p>	<p>possible consequences of natural and other disasters to population, material and cultural goods and the environment;</p> <p>1.2. Assessment and consequences of critical infrastructure;</p> <p>1.3. Final - specific assessments;</p> <p>1.4. Risk matrix;</p> <p>1.5. Scenarios;</p> <p>1.6. Maps.</p> <p>2. Data for position and characteristics of the territory, for which a risk assessment is being developed, shall be the basis for analysing the parts referred to in paragraph 1 of this Article and shall be part of risk assessment appendixes.</p> <p>3. Local level authorities shall include in their development plans the risk assessment and preventive measures, whose implementation would reduce the consequences and effects of disasters, in order to increase the level of security for population, material goods, critical infrastructure, cultural heritage and environment.</p>	<p>1.1. Vrste, intenzitet, efekti i moguće posledice prirodnih i drugih nepogoda na stanovništvo, materijalna, kulturna dobra i životnu sredinu;</p> <p>1.2. Procena i posledice kritične infrastrukture;</p> <p>1.3. Konačne-specifične procene;</p> <p>1.4. Matrica opasnosti;</p> <p>1.5. Scenariji;</p> <p>1.6. Mape.</p> <p>2. Podaci o poziciji i karakteristikama teritorije za koju se izrađuje dokument o proceni predstavljaju osnovu za analizu odeljka iz stava 1. ovog člana i dela priloga za procenu.</p> <p>3. Vlasti na lokalnom nivou u svojim razvojnim planovima treba da uključe procenu rizika i mere za sprečavanje, čije sprovođenje će umanjiti posledice i efekte nepogoda u cilju povećanja nivoa bezbednosti stanovništva, materijalnih dobara, kritične infrastrukture, kulturnog nasleđa i životne sredine.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 6 Llojet e fatkeqësive</p> <p>1. Fatkeqësitë, varësisht nga shkaktari i tyre ndahen në:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Fatkeqësi natyrore;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Fatkeqësi tjera.</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Types of disasters</p> <p>1. Depending on their cause, disasters shall be divided into:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Natural disasters;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Other disasters.</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Vrste nepogoda</p> <p>1. Nepogode se u zavisnosti od uzroka dele na:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Prirodne nepogode;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Druge nepogode.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore</p> <p>1. Vlerësimi i autoriteteve të nivelit lokal bazohet në analizën e rreziqeve dhe pasojave të mundshme në popullatë, në të mira materiale, trashëgimi kulturore dhe mjedis, nga:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Vërshimet, duke i përfshirë:</p> <p style="padding-left: 80px;">1.1.1. Treguesit hidrologjikë, siç janë: lumenjtë, liqenet dhe rezervuarët të cilët mund të jenë shkaktarë të vërshimeve, rreziqet nga vërshimi i lumenjve apo përrrenjve të bujshëm, pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve;</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Natural disaster risk</p> <p>1. The assessment of local level authorities shall be based on risk analysis and possible consequences to the population, material goods, cultural heritage and environment by:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Flooding, including:</p> <p style="padding-left: 80px;">1.1.1. Hydrologic indicators, such as rivers, lakes and reservoirs, which may be the cause of flooding, risks from the flooding of large rivers or streams, overview of threatened settlements with the number and structure of inhabitants;</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Opasnosti od prirodnih nepogoda</p> <p>1. Procena organa lokalnih vlasti zasniva se na analizi opasnosti i potencijalnih posledica za stanovništvo, materijalnih dobara, kulturnog nasleđa i životne sredine od:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Poplava, uključujući:</p> <p style="padding-left: 80px;">1.1.1. Hidrološke pokazatelje, kao što su: reke, jezera i rezervoari koji mogu biti uzrok poplava, opasnosti od poplava reka ili bujnih potoka, pregled ugroženih naselja sa brojem i strukturom stanovnika;</p>

<p>1.1.2. Nivelin e ndërtimeve në zona të caktuara, bazuar në dendësi të popullatës, industri, rrugë, lokacione kritike e të ngjashme.</p> <p>1.2. Tërmetet, duke i përfshirë:</p> <p>1.2.1. Karakteristikat sizmike të zonave dhe rrezikun sizmik për jetën e njerëzve, të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore;</p> <p>1.2.2. Rrezikshmërinë e zonave të caktuara, zonave urbane, bazuar në llojin e ndërtimeve, materialin ndërtimor dhe dendësinë e banimit;</p> <p>1.2.3 Shpeshtësinë e ndodhjes, intensitetet dhe epiqendrat e dridhjeve, së paku në 100 vitet e fundit me $M > 3.5$ shkallë të Rihterit;</p> <p>1.2.4. Pasojat e tërmeteve sipas zonave sizmike për objektet e banimit, objektet publike, objektet industriale dhe objektet tjera me përdorimin e shkallës MCS (Shkallë e Merkalit ose shkallë Evropiane e</p>	<p>1.1.2. Building level in certain areas based on the density of population, industry, roads, critical locations and similar.</p> <p>1.2. Earthquakes, including:</p> <p>1.2.1. Seismic features of the zones and seismic risk to human life and material good and cultural heritage;</p> <p>1.2.2. Hazardousness of certain areas, urban areas, based on the type of construction, construction material and residential density;</p> <p>1.2.3. Frequency of occurrence, intensities and epicentres of vibration in at least last 100 years with $M > 3.5$ Richter scale;</p> <p>1.2.4. Consequences of earthquakes by seismic areas for residential buildings, public facilities, industrial facilities and other facilities using the MCS scale (Mercalli Scale or European Macroseismic Scale (EMS-98));</p>	<p>1.1.2. Nivo izgradnje u određenim zonama, na osnovu gustine stanovništva, industriji, putevima, kritičnim lokacijama i slično.</p> <p>1.2. Zemljotrese, uključujući:</p> <p>1.2.1. Seizmičke karakteristike zona i seizmičku opasnost po život ljudi, materijalnih dobara i kulturnog nasleđa;</p> <p>1.2.2. Opasnost određenih zona, urbanih zona na osnovu vrste izgradnje, građevinskog materijala i gustine stanovanja;</p> <p>1.2.3. Učestalost dešavanja, intenzitet i epicentar potresa, barem u poslednjih 100 godina, sa $M > 3,5$ Rihterove skale;</p> <p>1.2.4. Posledice zemljotresa prema seizmičkim zonama za stambene objekte, javne objekte, industrijske objekte i druge objekte koji koriste MCS (Merkalijevu skalu ili evropsku makrosizmičku skalu (EMS-98));</p>
---	---	--

<p>Makrosizmike (EMS-98);</p> <p>1.2.5. Hartat sizmike, probabiliteti me nxitim për periudhën përsëritëse prej 95 dhe 975 vjet.</p> <p>1.3. Zjarret, duke i përfshirë:</p> <p>1.3.1. Karakteristikat e terrenit dhe vatrave potenciale të zjarreve, kushtet klimatike, intensitetin, shpeshësinë e paraqitjes, kohëzgjatjen, sipërfaqen e përfshirë;</p> <p>1.3.2. Zjarret fushore, malore, urbane, zjarret e shkaktuara si pasojë e proceseve tekniko-teknologjike, zjarret e shkaktuara nga incidentet dhe aktet terroriste;</p> <p>1.3.3. Vendbanimet e rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve;</p> <p>1.3.4. Treguesit statistikor të periudhave kohore-vjetore të zjarreve, muajt më kritik të zjarreve për 10-50 vitet e fundit, numrin dhe dëmet e përlllogaritura të zjarreve dhe</p>	<p>1.2.5. Seismic maps, probability with a return period of 95 and 975 years.</p> <p>1.3. Fires, including:</p> <p>1.3.1. Characteristics of the terrain and potential wraths of fires, climatic conditions, intensity, and frequency of occurrence, duration, and surface covered;</p> <p>1.3.2. Field, mountains, urban fires and fires caused due to technical-technological processes, fires caused by incidents and terrorist acts;</p> <p>1.3.3. Settlements risked by the number and structure of residents;</p> <p>1.3.4. Statistical indicators of the time periods—years of fires, most critical months for fires in the last 10-50 years, number and damages calculated and reflection in the Des-Inventory.</p>	<p>1.2.5. Seizmičke mape, verovatnoća u žurbi za period ponavljanja od 95 i 975 godina.</p> <p>1.3. Požari, uključujući:</p> <p>1.3.1. Karakteristike terena i potencijalnih žarišta požara, klimatske uslove, intenzitet, učestalost pojave, trajanje, obuhvaćenu površinu;</p> <p>1.3.2. Poljski požari, planinski požari, urbani požari izazvani kao posledica tehničko-tehnoloških procesa, požari izazvani incidentima i terorističkim aktima;</p> <p>1.3.3. Ugrožena naselja sa brojem i strukturom stanovnika;</p> <p>1.3.4. Statistički pokazatelji vremenskih-godišnjih perioda požara, najkritičniji meseci požara u poslednjih 10-50 godina, izračunati broj i šteta od požara i pregled u Des-Inventaru.</p>
---	---	--

<p>pasqyrimin në Des-Inventar.</p> <p>1.4. Rrëshqitjet dhe erozionet, duke përfshirë:</p> <p>1.4.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale të rrëshqitjes dhe erozioneve, kushtet klimatike, intensitetin, shpeshësinë e paraqitjes, sipërfaqen e përfshirë;</p> <p>1.4.2. Zonat e rrezikuara nga rrëshqitjet dhe erozioni së bashku me numrin e banorëve, të objekteve, llojin e tyre, pasqyrën e lokacioneve kritike (rrëshqitjet aktive dhe pasive), si dhe përshkrimi i strukturave gjeologjike të tokës.</p> <p>1.5. Reshjet e dëborës dhe ngricat, duke i përfshirë:</p> <p>1.5.1. Karakteristikat e terrenit dhe zonave potenciale me të reshura të dendura të dëborës, ngricat, intensiteti i reshjeve, temperaturës ekstreme, gjendja e infrastrukturës, shpeshësia e paraqitjes;</p> <p>1.5.2. Treguesit realë të reshjeve</p>	<p>1.4. Landslide and erosions, including:</p> <p>1.4.1. Terrain characteristics and potential landslide and erosion areas, climatic conditions, intensity, frequency of occurrence and surface covered;</p> <p>1.4.2. Threatened areas by landslides and erosion together with the number of residents, facilities, their type, reflection of critical locations (active and passive landslide) and the description of geological structures of land.</p> <p>1.5. Snowfall and frost, including:</p> <p>1.5.1. Characteristics of the terrains and potential areas with heavy snowfall, frosts, intensity of precipitation, extreme temperature, condition of infrastructure, and frequency of occurrence;</p> <p>1.5.2. Real indicators of snowfall</p>	<p>1.4. Klizišta i erozije, uključujući:</p> <p>1.4.1. Karakteristike terena i potencijalnih zona klizišta i erozije, klimatske uslove, intenzitet, učestalost pojave, obuhvačenu površinu.</p> <p>1.4.2. Zone koje su ugrožene od klizišta i erozije zajedno sa brojem stanovnika, objekata, njihovu vrstu, pregled kritičnih lokacija (aktivna i pasivna klizišta) ako i opis geoloških struktura zemlje.</p> <p>1.5. Snežne padavine i mrazovi, uključujući:</p> <p>1.5.1 Karakteristike terena i potencijalnih zona sa obilnim snežnim padavinama, poledica, intenzitet padavina, ekstremnim temperaturama, stanje infrastrukture, učestalost pojave;</p> <p>1.5.2. Realni pokazatelji količine snežnih padavina kao i poledice koje</p>
--	---	--

<p>të dëborës për sasinë, si dhe ngricat të cilat mund ta ndryshojnë dukshëm funksionimin normal të furnizimit me produkte vitale dhe shërbime, sipas pasqyrës së vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve, duke përfshirë specifikat dhe zonat më të rrezikuara për muajt më kritik të vitit, bazuar në treguesit statistikorë për 10-20 vitet e kaluara.</p>	<p>for the quantities and frosts which may significantly alter the normal functioning of vital products and service delivery, based on the reflection of settlements threatened with the number and structure of residents, including specifics and areas most threatened during the most critical months of the year, based on the statistical indicators for the passed 10-20 years.</p>	<p>mogu značajno izmeniti normalno funkcionisanje snabdevanja sa vitalnim proizvodima i uslugama, prema pregledu ugroženih naselja sa brojem i strukturom stanovnika, uključujući specifičnosti i najugroženija područja koja su izložena riziku u najkritičnijim mesecima u godini, na osnovu statističkih pokazatelja za poslednjih 10-20 godina.</p>
<p>1.6. Breshëri, duke përfshirë: Treguesit statistikorë të pasojave nga breshëri për 10-20 vitet e kaluara, dëmet e evidentuara (përlllogaritura), muajt më kritik të vitit sipas evidencave statistikore, si dhe specifikacionin e zonave të rrezikuara;</p>	<p>1.6. Hail, including: Statistical indicators of consequences from hail for the last 10-20 years, recorded (accrued) damages, most critical months of the year based on statistical evidences and the specification of threatened areas;</p>	<p>1.6. Grad, uključujući: Statističke pokazatelje posledica od grada u poslednjih 10-20 godina, utvrđene štete(izračunate), najkritičniji meseci u godini prema statističkim dokazima i specifikacija ugroženih zona;</p>
<p>1.7. Ortekët, duke përfshirë: Treguesit statistikorë të pasojave nga ortekët për 10-20 vitet e kaluara, dëmet e evidentuara (përlllogaritura), muajt më kritik të vitit, cenueshmërinë, efektet sipas evidencave statistikore, pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve</p>	<p>1.7. Avalanches, including: Statistical indicators of consequences from avalanches in the 10-20 years, recorded (accrued) damages, most critical months of the year, vulnerability, effects by statistical evidence, overview of threatened settlements with the number and structure of residents including</p>	<p>1.7. Lavine, uključujući: Statističke pokazatelje posledica od lavina tokom poslednjih 10-20 godina, evidentirana šteta (izračunata), najkritičniji meseci u godini, ugroženost, efekti zasnovani na statističkim dokazima, pregled ugroženih naselja prema broju i strukturi stanovnika, uključujući specifičnosti i najugroženija zone;</p>

<p>duke përfshirë specifikat dhe zonat më të rrezikuara;</p> <p>1.8. Erërat e fuqishme dhe stuhitë, duke përfshirë: Treguesit statistikorë të pasojave nga erërat e fuqishme dhe stuhitë për 50 vitet e kaluara, dëmet e evidentuara (përlllogaritura), muajt më kritik të vitit, cenueshmërinë, efektet sipas evidencave statistikore, pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve duke përfshirë specifikat dhe zonat më të rrezikuara;</p> <p>1.9. Thatësira, duke përfshirë:</p> <p>1.9.1. Treguesit statistikorë të pasojave nga mungesa e theksuar e të reshurave atmosferike për 30 vitet e kaluara, dëmet e evidentuara (përlllogaritura), muajt më kritik të vitit, cenueshmërinë, efektet sipas evidencave statistikore, pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve duke përfshirë rezervat ujore (mbitokësore dhe nëntokësore) dhe zonat më të rrezikuara;</p> <p>1.9.2. Kushtet hidrometeorologjike, siç janë:</p>	<p>specifics and most threatened areas.</p> <p>1.8 Strong winds and storms, including: Statistical indicators of consequences from strong winds and storms in the past 50 years, recorded (accrued) damages, most critical months of the year, vulnerability, effects by statistical evidence, overview of threatened settlements with the number and structure of residents including specifics and most threatened areas;</p> <p>1.9. Drought, including:</p> <p>1.9.1. Statistical indicators of consequences from the highlighted lack of precipitation in the last 30 years, recorded (accrued) damages, most critical months of the year, vulnerabilities, effects under statistical evidences, reflection of threatened settlements by number and structure of residents, including water reserves (surface and underground) and most threatened areas;</p> <p>1.9.2. Hydro-metrological conditions, such as annual</p>	<p>1.8. Jaki vetrovi i oluje, uključujući: Statističke pokazatelje posledica od jakih vetrova i oluja u zadnjih 50 godina, procenjene štete (izračunate) , najkritičniji meseci u godini, ugroženost ,efekti prema statističkim evidencijama, pregled ugroženih naselja po broju i strukturi stanovnika, uključujući specifičnosti i najugroženije zone;</p> <p>1.9. Suša, uključujući:</p> <p>1.9.1. Statistički pokazatelji efekata jake nestašice atmosferskih padavina u zadnjih 30 godina, identifikovane štete (izračunate), najkritičniji meseci u godini, ugroženost, efekti prema statističkim evidencijama, pregled ugroženih naselja po broju i strukturi stanovnika, uključujući rezerve vode (nadzemne i podzemne) i najugroženije zone;</p> <p>1.9.2. Hidrometeorološki uslovi, kao što su: godišnji prosek padavina,</p>
---	--	---

<p>mesatarja vjetore e të reshurave, pasqyra e vendbanimeve të rrezikuara me numrin dhe strukturën e banorëve, objektet për menaxhimin e ujërave, masat e nevojshme parandaluese.</p> <p>1.10. Rreziqet nga epidemitë dhe pandemitë bazohen në: Vlerësimet dhe analizat e shërbimeve kompetente shëndetësore, sanitare, veterinerë, bujqësore, institucioneve përkatëse me specifikat e zonave më të rrezikuara, si dhe treguesit realë të shkaktarëve, bartësit dhe përgjegjësit e aktiviteteve të rregullta për reagim në raste të rreziqeve epidemike dhe pandemike.</p> <p>2. Personat juridik nga neni 3, paragrafi 3 i kësaj Rregulloreje, në vlerësimet e tyre i analizojnë efektet e dëmshme, të mundshme të ngjarjeve nga paragrafi 1 i këtij neni, në sigurinë e objekteve dhe mundësinë e ndikimit të tyre në paraqitjen e ngjarjeve të papritura me pasoja negative.</p>	<p>average of precipitation, overview of threatened settlements by number and structure of residents, water management facilities, necessary preventive measures.</p> <p>1.10. Risk of epidemics and pandemics is based on: Assessments and analyses of competent healthcare, sanitary, veterinary, agricultural services, relevant institutions with the specifics of the most threatened areas and the real indicators of the causes, the bearers and responsibilities of the regular activities for reactions in case of epidemic and pandemic threats.</p> <p>2. Legal persons referred to in Article 3, paragraph 3 of this Regulation, shall analyse in their assessments the harmful, potential effects of the occurrences referred to in paragraph 1 of this Article, in the safety of facilities and the possibility of their influence in the occurrence of unexpected occurrences with negative consequences.</p>	<p>pregled ugroženih naselja sa brojem i strukturom stanovnika, vodoprivredni objekti, neophodne mere predostrožnosti.</p> <p>1.10. Opasnosti od epidemije i pandemije zasnivaju se na: Proceni i analizi nadležnih zdravstvenih, sanitarnih, veterinarskih, poljoprivrednih službi, odgovarajućih institucija sa specifičnostima najugroženijih područja, kao i realnih pokazatelja uzroka, nosioca i odgovornih za redovne aktivnosti reagovanja u slučaju epidemijskih i pandemijskih opasnosti.</p> <p>2. Pravna lica iz člana 3. stav 3. ove uredbe u svojim procenama analiziraju moguće štetne efekte događaja iz stava 1. ovog člana na bezbednost prostorija i mogućnost njihovog uticaja na pojavu neočekivanih događaja sa negativnim posledicama;</p>
--	--	---

<p align="center">Neni 8 Rreziqet nga fatkeqësitë tjera</p>	<p align="center">Article 8 Risk from other disasters</p>	<p align="center">Član 8 Opasnosti od drugih nepogoda</p>
<p>1. Vlerësimi i autoriteteve nga rreziqet e fatkeqësive tjera bazohet në analizën e plotë të rreziqeve dhe pasojave të mundshme në popullatë, në të mira materiale, kulturore dhe mjedis, brenda zonës së tyre, si dhe atyre që mund të vijnë nga zonat fqinje si në vijim:</p> <p>1.1. Numrin, llojin dhe madhësinë e objekteve në të cilat deponohen, përdoren apo prodhohen materiet e rrezikshme;</p> <p>1.2. Numrin, llojin dhe cenueshmërinë e trafikut rrugor, hekurudhor dhe ajror;</p> <p>1.3. Llojin dhe sasinë e materieve të rrezikshme;</p> <p>1.4. Distancën nga zonat e banuara;</p> <p>1.5. Përqendrimin e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme të cilat mund ta rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe tërë strukturës ekologjike me pasqyrën e ndërmarrjeve të cilat merren me prodhimin, deponimin dhe shitjen e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme;</p>	<p>1. Assessment of other disasters by authorities shall be based on the complete analysis of possible risks and consequences to the population, material and cultural goods and environment, within their area, as well as those that may come from neighbour areas, as follows:</p> <p>1.1. Number, type and size of facilities in which dangerous matters are stored, used or produced;</p> <p>1.2. Number, type and vulnerability of road, rail and air traffic;</p> <p>1.3. Type and quantity of hazardous matters;</p> <p>1.4. Distance from residential areas;</p> <p>1.5. Concentration of dangerous and harmful matters that may risk the human and animal health and the whole ecological structure, with an overview of enterprises that produce, store and sale hazardous and harmful matters;</p>	<p>1. Procena autoriteta o opasnostima i drugim nepogodama zasniva se na detaljnoj analizi opasnosti i potencijalnih posledica po stanovništvo, materijalna, kulturna dobra i životne sredine unutar njihove zone i onih koji mogu doći iz susednih zona kako sto sledi:</p> <p>1.1. Broj, vrstu i veličinu objekata u kojima se deponiraju, koriste ili proizvode opasni materijali;</p> <p>1.2. Broj, vrstu i ugrođenost drumskog, železničkog i vazdušnog saobraćaja;</p> <p>1.3. Vrstu i količinu opasnih materija;</p> <p>1.4. Udaljenost od stambenih zona;</p> <p>1.5. Koncentracija opasnih i štetnih materija koja mogu ugroziti život i zdravlje ljudi, životinja i čitave ekološke strukture od preduzeća koja vrše proizvodnju, deponovanje i prodaju opasnih i štetnih materija;</p>

<p>1.6. Llojin dhe sasinë reale të materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në qarkullim, dendësisë së trafikut dhe zonave nëpër të cilat transportohen, vendbanimet, sipërfaqet bujqësore, lumenjtë, liqenet e të ngjashme;</p> <p>1.7. Rrjedhjen e materieve të rrezikshme dhe të dëmshme në vendet me rrezikshmëri të lartë - tubacionet, rrugët të cilat kalojnë nëpër vendet me specifika të veçanta;</p> <p>1.8. Nga shpërthimi i pendëve hidro-akumuluese, ku rreziku i mundshëm bazohet në:</p> <p>1.8.1. Potencialin akumulues të liqeneve, përkatësisht pozitës së tyre, në mundësinë potenciale të shpërthimit të pendës ose argjinaturës hidro-akumuluese, ku do të rrezikohet popullata dhe të mirat materiale në drejtim të lëvizjes së valës së ujit;</p> <p>1.8.2. Pasqyrën e rezultateve të matjeve dhe vlerësimin e gjendjes së trupit të pendës.</p> <p>2. Vlerësimi për fatkeqësitë nukleare,</p>	<p>1.6. Real type and quantity of hazardous and harmful types in circulation, density of traffic and areas through which are transported, settlements, agricultural surfaces, rivers, lakes and similar;</p> <p>1.7. Leakage of hazardous and harmful materials in sites with high hazardousness – pipes, roads which pass through the sites with special specifications;</p> <p>1.8. From the explosion of hydro accumulating dam, where the possible risk is based on:</p> <p>1.8.1. Accumulating potential of lakes, namely their position, in the possibility of dam or hydro accumulating embankment, where the population and material goods would be threatened in the direction of water flow; and</p> <p>1.8.2. Overview of results of measurements and assessment of the condition of the dam body.</p> <p>2. Assessment for nuclear, radiologic,</p>	<p>1.6. Vrstu i realnu količinu opasnih i štetnih materija u prometu, gustinu saobraćaja i zona kroz koja se prevoze, naselja, poljoprivredne površine, reke, jezera i slično;</p> <p>1.7. Izliv opasnih i štetnih materija u mestima visokog rizika - cevovod, putevi koji prolaze kroz mesta sa posebnim specifikacijama;</p> <p>1.8. Od izliva hidro-akumuliranih brane gde se mogući rizik zasniva na:</p> <p>1.8.1. Kumulativni potencijal jezera odnosno njihove pozicije u potencijalnoj mogućnosti pucanja brane ili hidroakumulacionog nasipa, što bi moglo ugroziti stanovništvo i materijalna dobra u pravcu kretanja vodenog talasa;</p> <p>1.8.2. Pregled rezultata merenja i procena stanja strukture brane.</p> <p>2. Procena nuklearnih, radioloških, hemijskih</p>
---	---	---

<p>radiologjike, kimike dhe biologjike hartohet ekskluzivisht në nivelin qendror, ndërsa autoritetet e nivelit lokal planifikojnë zbatimin e obligimeve që dalin nga planet dhe programet qendrore të kësaj fushe.</p>	<p>chemical and biological disasters shall be exclusively developed at the central level, while the local level authorities shall plan the implementation of obligations arising from central plans and programs of this field.</p>	<p>i bioloških katastrofa isključivo se izrađuje na centralnom nivou, dok vlasti na lokalnom nivou planiraju da sprovede obaveze koje proizilaze iz centralnih planova i programa u ovoj oblasti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Rreziqet nga veprimet luftarake dhe terroriste</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Risks from military and terrorism actions</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Opasnost od borbenih i terorističkih akcija</p>
